

SHËRBIMET BAZË TË ARKITEKTIT

AB Parashikimet dhe programet projektuese

	01 Merr informatat prej klientit për lokacion
	02 Viziton lokacionin dhe merr informatat paraprake
	03 Asiston klientit në përpilimin e kërkesave
	04 Sugjeron klientin për mundësitë e ndryshme të konstruksionit
	05 Sugjeron nëse ka nevojë për specialistë të tjerë të kyçen në projekt
	06 Përgatitë propozimet
	07 Bën studime të nevojshme për leverdishmërinë (fisibilitetin) e kërkesave të klientit
	08 Kontrollon së bashku me klientin mundësitë alternative konstruktive dhe të design-it
	09 Këshillon klientin për nevojë të marrjes së lejeve për ndërtim
	10 Zhvillon kërkesat e klientit
	11 Sugjeron në lidhje me ambientin dhe rrethinën

C Propozimet (zgjidhja ideore/zgjidhja urbane) dhe vlera investive

	01 Analizon kërkesat e klientit dhe përgatitë propozimet
	02 Ofron informata të specialistëve tjerë për objekt dhe diskuton të dhënat
	03 Përgatitë vlerën e përafërt investive
	04 Paraqet të dhënat të vlerave investive klientit për aprovim

D Projekti Ideor

	01 Zhvillon projektin ideor për propozim
	02 Shkëmben informata me profesionistë të tjerë dhe inkorporon ato në zgjidhje më të mirë ideore
	03 Shkëmben informata me profesionistë të tjerë dhe kërkon shumat e mundshme investive për fazat e tyre
	04 Konsulton subjektet përgjegjëse
	05 Konsulton autoritetet ndërtimore
	06 Konsulton zjarrfikësit
	07 Konsulton autoritetet ambientale
	08 Konsulton autoritetet e licencave
	09 Paraqet projektin ideor final para klientit për aprovim

E Projekti Kryesorë

	01 Zhvillon projektin zbatues bazuar në projektin ideor të aprovuar
	02 Shkëmben informata me profesionistë të tjerë dhe inkorporon informatat e tyre në projekt zbatues
	03 Shkëmben informata me profesionistë të tjerë te tjerë dhe kërkon revizionet në shumta e tyre te mundshme
	04 Përgatitë informata në bazë të normave dhe rregullativave
	05 Merr pëlqimin e klientit për llojin e konstruksionit, kualitetin e materialit dhe standardet

FG Informacionet për ndërtimin e objektit dhe Paramasa dhe parallogaria

	01 Përgatitë vizatimet dhe shënimet e nevojshme për zbatimin e objektit
	02 Përgatitë specifikacionin e materialit të nevojshëm
	03 Jep informata profesionisteve tjerë për përgatitjen e preventivit dhe planit dinamik
	04 Shkëmben informata me profesionistë të tjerë dhe inkorporon informatat e tyre në fazë
	05 Koordinon informatat për zbatimin e projektit
	06 Shkëmben informata me profesionistë të tjerë dhe kërkon revizionet e mundshme te kostove ndërtimore
	07 Rishqyrton planin dinamik të ndërtimit

H Tenderi

	01 Sugjeron klientin, dhe merre pëlqimin për listën e mundshme të zbatuesve
	02 Kërkon participimin formal të tenderëve
	03 Jep informatat dhe raportin profesionistëve të tjerë në lidhje me tender
	04 Merr pëlqimin per formen e kontratës ndërtimore dhe tregon obligimet e Klientit ndaj tyre.

J Planifikimi i Projektit

	01 Sugjeron klientin, dhe merr pëlqimin për emërimin e zbatuesit
	02 Përgatitë kontratën për ndërtim dhe mbikëqyrë nënshkrimin e saj
	03 Jep informata për veprim në bazë të kontratës së nënshkruar me zbatuesin.

KL Mbikëqyrja në punishte dhe kompletimi i punëve

	01 Administron klauzolat e kontratës së nënshkruar me zbatuesin
	02 Mbanë takime (sipas nevojës) me zbatuesin
	03 Jep informata profesionisteve të tjerë dhe inkorporon informatat e tyre në raportin financiar
	04 Kontrollon dhe miraton materialet e livruara në punishte
	05 Sipas nevojës merr mostrat dhe kërkon testet e materialeve, komponentëve, teknikave dhe mënyrave të punës dhe shqyrton, verifikon dhe aprovon këto në punishte
	06 Sipas kërkesës angazhon hapjen e strukturës së objektit dhe verifikimin e materialeve dhe mënyrës së ekzekutuar të projektit
	07 Sipas nevojës viziton fabrikat, uzinat ose punishtet e materialit, shqyrton specifikimet para arritjes se tij në punishte
	08 Në intervale te caktuara të zhvillimit të punëve në punishte bën mbikëqyrjen e kualitetit të materialeve dhe punëve sipas kontratës ndërtimore.
	09 Drejton dhe ndikon në operacionalizimin e dinamikës
	10 Monitoron progresin e punëve në punishte dhe raporton në lidhje me to klientin